

Kerkim Tregu per Sektorin e Veres ushqimore dhe Vreshtarise ne Shqiperi

July 15

2014

Ky studim eshte kerkuar dhe
mundesuar me financim nga Vera
Librazhd shpk dhe BAS EBRD

[Type the
document
subtitle]

Regional Development Agency (SME) Tirana

Rruga Ismail Qemali, P 34/1, Ap 2/3



Contents

1. Historiku dhe ecuria e zhvillimit te Tregut boteror dhe rajonal i veres.....	3
2. Prodhimi vendas dhe importi i veres ne vendin tone.....	5
2.1 Tregu i vreshtarise ne vendin tone.	5
2.2 Tregu i veres ne vendin tone.	8
2.3 Importi i veres ne vendin tone.....	8
3. Konsumi i veres ne vendin tone dhe trendi i kerkese-ofertes.....	10
4. Cmimet e vererave, dinamika e strategjia e tyre dhe konkurrenca.	12
5. Operatoret kryesore	14
6. Analiza swot e tregut te vreshtarise dhe prodhimit te veres	14
7. Profilet e disa prej prodhuesve kryesore të vererave në vendin tonë	16

Abstarkt

Industria e prodhimit te veres ushqimore dhe vreshtarise ne Shqiperi eshte nje industri e njohur dhe me tradite ne Shqiperi. Ne tregun aktual krahas prodhimeve te vendese te veres ushqimore te prodhuara ne Fabrikat dhe kantinat e veres me shperndarje te ndryshme ne Shqiperime dominante ne kete treg praqiten dhe pijet e importit e kryesisht italiane, farnceze, apo dhe te rajonit si ato te Malit te Zi, Maqedonise e Kosoves etj. Pare ne kete konteks zhvillimi kesaj industrie ne vend kerkon nje vemendje te vecante dhe paraqitet mjaft komplekse persa i perket varieteteve te rrushit te prodhuar ne vreshtat shqipater e games se pijeve sipas varieteteve te hedhura ne treg me brand name te ndryshme.

Zhvillimi i industrise se prodhimit te te veres ushqimore synon plotesimin e shijes konsumatore me prodhime vendi, dhe si e tille kjo industri merr ne konsiderate vreshtat, prodhuesit vendas (kantinat dhe fabrika), ofruesit e amballazhit dhe tregtetet lokale. Nderkohe faktor shume irendesishem ne kete treg mbeten pa dyshim importuesit e ketyre produkteve nga Italia, Franca, USA, Greqia, e Kili por dhe nga rajoni Ballkanit.

Ky produkt ze nje peshe modeste te shpenzimeve familjare por qe rritet nga viti ne vit si rezultat i rritjes se nivelit ekonomik dhe permiresimit te dietes ushqimore. Konkurenca e prodhimeve te importit eshte mjaft e ndeshur pasi vera e mire ofron mundesine liberalizimit te cmimit cka perkthehet vere cilesore cmim i paguar nga konsumatori.

Plotesimi i standarteve te prodhimit dhe te higjenes se produktit, certifikimit te produktit, kushteve per rritjen e sigurise ushqimore, magazinimit dhe tregtimit sipas te gjitha normave te komunitetit europian jane disa nga ceshtjet qe po e shqetesojne sipermaresin shqiptar.

Investimet e reja qe do te kryhen ne kete sektor kane nevojte te mbeshteten ne te dhena reale mbi situaten e sektorit ne nvele makro dhe mikro si dhe marrveshjet e tregtise se lire ne rajon.

Per kryerjen e ketij studimi eshte angazhuar stafi i ARZH Tirane: Ilir Rembeci-Drejtori i ARZH, Jorgo Dhimarko - Specialist kerkimi, Godiva Rembeci-Specialiste Kerkimore dhe Arben Rapo- e Specialist ne fushen e Shitjeve.

Studimi eshte mbeshtetur ne nje proces te gjate qe ka konsistuar kryesisht ne diagnozen ne kompani, mbledhje e informacionit, perpunimit te dhenave si dhe realizimit te nje sere intervistash me stafin lider te kompanise si dhe aktoret kryesor qe operojne ne kete treg. Nje falenderim i vecante ne lidhje me ecurine e ketij studimi i adresohet specialisteve te fabrikes Vera Lib razhd Z Rahman Gjeta dhe Ali per bashkepunimin e frytshem ne drejtim te ofrimit te dhenave, komenteve dhe sugjerimeve te nevojshem per kete sektor.